

Komiteti i Monitorues BE – Kosovë i Instrumentit për Reforma dhe Rritje

E mërkurë, 17 qershor 2026, Prishtinë, Kosovë

KONKLUSIONE OPERATIVE

1. ÇËSHTJET HORIZONTALE QË NDIKOJNË NË ZBATIM

1. Zyra e Kryeministrit (ZKM), në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e linjës, do të vazhdojë të sigurojë koordinim në kohë dhe të strukturuar, konsultime të hershme me Komisionin Evropian (KE), dhe të forcojë planifikimin e monitorimit të tërë ciklit të reformave, për të mbështetur zbatim efektiv, dorëzimin në kohë të dokumentacionit të plotë dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Agjendës së Reformave dhe Marrëveshjes për Instrumentin.
2. ZKM do të vazhdojë të organizojë takime në nivel teknik me institucionet e linjës dhe me Zyrën e BE-së dhe shërbimet e KE-së me qëllim të lehtësimit të komunikimit për çështje konkrete, sqarimit të çështjeve të hapura dhe mbështetjes së zbatimit në kohë të hapave të reformave.
3. Institucionet e Kosovës përgjegjëse për zbatimin e reformave, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Koordinatorin Kombëtar të Instrumentit për Reforma dhe Rritje (Koordinatorin Kombëtar të IR), do të sigurojnë harmonizimin ndërmjet prioritetëve të reformave dhe planifikimit të financave.
4. ZKM do të shfrytëzojë hartëzimin e bashkëpunimit për zhvillim si mjet për të siguruar transparencë, koordinim të përkrahjes së jashtme dhe parandalimin e financimit të dyfishtë. Për ta lehtësuar këtë, Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma dhe Rritje (KM i IR) i inkurajon partnerët për zhvillim që t'i ofrojnë rregullisht ZKM-së/ZBZH-së informata të hollësishme, në kohë të duhur, mbi përkrahjen në vazhdim e sipër dhe atë të planifikuar në kohën e duhur. Bazuar në këtë ushtrim të hartëzimit të bashkëpunimit për zhvillim, ZKM/ZBZH do të punojë me BE-në dhe partnerët e tjerë për zhvillim, dhe do të iniciojë zhvillimin e një sistemi të centralizuar, të bazuar në performancë, të monitorimit të partnerëve për zhvillim, i cili do të mundësojë prezantimin e produkteve, rezultateve dhe përfituesve, si mjet për të rritur transparencën, forcuar koordinimin dhe inkurajuar një qasje komplementare dhe sinergji në financimin nga partnerët për zhvillim.
5. KE, në koordinim me Koordinatorin Kombëtar të IR, do të ofrojë sqarime shitesë mbi kushtet që mund të vlejné për vlerësim të zbatimit të pjesshëm dhe pagesa të pjesshme për reformat, me qëllim që të sigurohet të kuptuarit e njëjtë dhe parashikueshmëri në zbatim.

2. PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE MONITORIMI

6. ZKM do të vazhdojë të zbatojë dhe zhvillojë më tej kornizën e vendosur të monitorimit, duke integruar vlerësimin e rrezikut si pjesë të monitorimit dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë, qartësinë dhe afatet kohore për përcjellje të zbatimit dhe raportim.
7. Koordinatorin Kombëtar të IR, në bashkëpunim me institucionet zbatuese, do të identifikojë në mënyrë proaktive hapat e reformave që kërkojnë konsultim paraprak me shërbimet e KE-së ose organe të tjera përkatëse dhe do t'ua komunikojë qartë ministrive të linjës datat e pritura të dorëzimit të tyre. Kjo do të mundësojë planifikim të duhur dhe do të sigurojë koordinim në kohë (në vazhdimësi).

8. Për hapat që kërkojnë përafrim me *acquis* të BE-së, ZKM do të sigurojë që legjislacioni t'i dërgohet KE-së për konsultime në kohën e duhur, të paktën tre muaj para afatit të raportimit, pasi të jenë kryer konsultimet publike dhe para se një projektligj të miratohet nga Qeveria. Projektligji duhet të shoqërohet nga përkthime zyrtare, Tabelat e Pajtueshmërisë dhe një përmbledhje e konsultimeve publike.
9. Duhet të kihet parasysh koha e nevojshme që shërbimet e KE-së ta shqyrtojnë një projektligj, përfshirë nevojën për të siguruar që komentet e KE-së të adresohen dhe ndryshimet e kërkuara të integrohen nga Qeveria para se projektligji t'i dërgohet Kuvendit. KE përpaket ta shqyrtojë legjislacionin shpejt, por varësisht nga ngarkesa e punës, kompleksiteti dhe cilësia e draftit të dorëzuar nga Kosova, procesi i shqyrtimit nga KE pritet të zgjasë tre muaj. Legjislacioni për konsultim do të dorëzohet zyrtarisht nga ZKM dhe ajo do të koordinohet me institucionet përkatëse të linjës për të marrë çfarëdo kontributi të mëtejshëm që nevojitet.
10. Koordinatori Kombëtar i IR, në bashkëpunim me institucionet zbatuese, do të vendosë masa konkrete për të parashikuar më mirë përfundimin e reformave brenda afateve dhe për të zvogëluar më tej numrin e hapave të reformave në periudhë shtesë të shumë përpara skadimit të tyre.
11. KM i IR do të mbetet forumi qendror për monitorimin dhe vlerësimin e përparimeve në zbatimin e Agjendës së Reformave, ndërsa do të vazhdojë të ndiqet qasja komplementare me strukturat e tjera të themeluara, në mënyrë koherente dhe ashtu që të forcojnë njëra-tjetrën. Pjesëmarrja e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) në KM të IR do të vazhdojë të sigurohet në përputhje me Rregulloren e dakorduar të Punës.
12. Sipas nevojës, KE, në koordinim me Koordinatorin Kombëtar të IR, do të vazhdojë të ofrojë udhëzime për të siguruar që kërkesat të kuptohen në mënyrë konsistente. Në rastet kur përfituesi vëren se një hap ose një burim verifikimi nuk është përkufizuar mjaftueshëm, duhet të ndërmerren veprime korrigjuese sa më shpejt që të jetë e mundur para afatit të hapit përkatës.
13. Koordinatori Kombëtar i IR, në bashkëpunim me institucionet zbatuese, do të sigurojë ndërmarrjen me kohë të veprimeve pasuese në raport me boshllëqet e identifikuara në zbatim, përfshirë dorëzimin e sërishëm të raporteve për zbatimin e hapave, në rastet kur ndodh kjo. KE-ja do të sigurojë vlerësim me kohë.
14. Përfituesi do të sigurojë qëndrueshmërinë lidhur me hapat e përmblusur, në përputhje me Marrëveshjen për Instrumentin, dhe do ta informojë KE-në në kohë të duhur për çfarëdo rreziqesh për zbatim të qëndrueshëm. Për hapat që kërkojnë zbatim të vazhdueshëm, përfituesi do ta informojë në mënyrë proaktive KE-në në çdo kërkesë për pagesë për çfarëdo zhvillimesh ose veprimesh të ndërmarra deri në atë kohë.
15. Përveç pjesëmarrjes në KM të IR, ZKM do të vazhdojë të organizojë takime të dedikuara me OSHC-të përpara dorëzimit të çdo kërkesë për pagesë, me qëllim sigurimin e transparencës, dialogut dhe shkëmbimit të strukturuar të informatave.
16. Qeveria do të sigurojë transparencën dhe do të vazhdojë të punojë në mënyrë të strukturuar dhe të hapur me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara, përfshirë përmes dërgimit me kohë të dokumentacionit përkatës dhe publikimit të kërkesave për

pagesë, me përjashtime në përputhje me legjislacionin në fuqi për interesin publik dhe privatësinë e individëve.

3. AUDITIMI DHE KONTROLLI

17. Institucionet që zbatojnë Instrumentin për Reforma dhe Rritje (IR) do të sigurojnë kryerjen në mënyrë të duhur të funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit. Koordinatori Kombëtar i IR do të vazhdojë të koordinojë zbatimin e kornizës së kontrollit për IR dhe, sipas nevojës, do të mbështesë forcimin e mëtejshëm të këtij funksioni në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe institucionet zbatuese.
18. Deklaratat e garancisë do të vazhdojnë të bazohen në deklaratat e menaxhmentit të dorëzuara nga drejtuesit e institucioneve dhe do të përfshijnë përmbledhje të auditimeve të kryera, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Koordinatori Kombëtar i IR do të forcojë kontrollet lidhur me informatat mbi zbatimin e reformave dhe do të forcojë kornizën e vlerësimit të riskut, veçanërisht në lidhje me financimin e dyfishtë dhe parregullsitë.
19. Koordinatori Kombëtar i IR, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe institucionet zbatuese, do të sigurojë ndërmarrjen e aktiviteteve pasuese lidhur me gjetjeve dhe rekomandimet e dala nga Auditimi i sistemit që është kryer përmes përgatitjes së një Plani Veprimi, i cili do t' dërgohet Komisionit Evropian dhe do t'u vihet në dispozicion anëtarëve të KM të IR.
20. Koordinatori Kombëtar i IR dhe institucionet relevante do të sigurojnë adresimin sistematik të rekomandimeve të auditimit që lidhen me IR, duke përdorur sistemet ekzistuese për ndërmarrjen e hapave pasues lidhur me auditimin, aty ku janë në dispozicion, dhe duke mirëmbajtur një mekanizëm plotësues të përcjelljes lidhur me këtë, sipas nevojës për qëllim të monitorimit dhe raportimit për IR.

4. Investimet përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF)

21. Kosova do të intensifikojë përpjekjet për të përmirësuar Menaxhimin e Investimeve Publike dhe për të përditësuar Listën Prioritare të Projekteve Infrastrukturore për Kosovën, për të drejtuar në mënyrë të duhur dhe pa vështirësi financimin nga BE-ja dhe partnerët e tjerë për zhvillim në mënyrë komplementare.
22. Ndërsa lista prioritare e projekteve infrastrukturore e WBIF mbetet indikative, ZKM/ZBZH do të dorëzojë një listë të rishikuar prioritare të projekteve infrastrukturore të WBIF në kuadër të IR dhe do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm dhe shqyrtimin periodik të saj, përfshirë identifikimin dhe dorëzimin me kohë të projekteve që kanë arritur pjekuri të mjaftueshme për zbatim.
23. KE, institucionet financiare ndërkombëtare (IFN-të) dhe autoritetet ftohen të rrisin më tej efikasitetin dhe efektivitetin e funksionimit të mbështetjes së WBIF, përfshirë procedurat përkatëse, duke korrigjuar në të njëjtën kohë vonesat në zbatimin e projekteve.

5. KOMUNIKIMI DHE PROMOVIMI

24. Autoritetet do të vazhdojnë të zbatojnë Planin e Komunikimit dhe Promovimit, në bashkëpunim me Zyrën e BE-së, duke siguruar ekzekutimin me kohë të aktiviteteve të

planifikuara, burime të mjaftueshme dhe harmonizimin e mesazheve kryesore në konsultim me KE-në.

25. Koordinatori Kombëtar i IR do të ofrojë rregullisht raportim të përditësuar mbi gjendjen lidhur me aktivitetet e komunikimit dhe promovimit, përfshirë në takimet e KM të IR dhe në raportin vjetor të RGF-së.
26. Koordinatori Kombëtar i IR zotohet të publikojë me kohë informata lidhur me zbatimin e Agjendës së Reformave në ueb-faqen e dedikuar të Qeverisë.